



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Ministria e Financave
Ministarstvo Finansija - Ministry of Finance

Njësia Qendrore për Harmonizimin e Auditimit të Brendshëm
Centralna Jedinica za Harmonizaciju Unutrašnje Revizije - Central Harmonization Unit on Internal Audit

Nr. ~~01~~/2019

Datë: 25./06/2019

Ministria e Financave në mbështetje të Nenit 28 paragrafi 3.3 dhe 3.4 dhe Nenit 30 paragrafi 3.4 të Ligjit Nr. 06/L-021 për Kontrollin e Brendshëm të Financave Publike, për hartimin dhe administrimin e politikave kombëtare për trajnim, çertifikim dhe për zhvillim të vazhdueshëm profesional të auditorëve të brendshëm, sipas praktikave ndërkombëtare në fushën e auditimit të brendshëm, nxjerr, këtë:

V E N D I M

1. Me këtë vendim përcaktohen kriteret për certifikimin e auditorëve të brendshëm të ndërmarrjeve publike në programin për trajnim dhe çertifikim të auditorëve të brendshëm për sektorin publik të cilët janë në moshën para pensionimit.
2. Auditorët e brendshëm të ndërmarrjeve publike të cilët kanë vitin e lindjes 1959 e më herët ose 5 vite para moshës së pensionimit nuk do të përfshihen në programin kombëtar për trajnim dhe çertifikim të auditorëve të brendshëm të sektorit publik.
3. Auditorët e brendshëm që plotësojnë kriterin e pikës 2 do t'u mundësohet zhvillimi i veprimtarisë së auditimit të brendshëm në Subjektin e Sektorit Publik deri në daljen e tyre në pension.
4. Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.



Iu dërgohet:
Ndërmarrjeve Publike të Republikës së Kosovës
Arkivit të MF-it